



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 80

Prishtinë, më 14.06.2013, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 302

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Fatmir Xhelili, Goran Marinković, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu, Rasim Demiri.

Munguan: Anton Quni, Danush Ademi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Naim Hoxha, këshilltar nga OSBE- ja; Dhurata Kryeziu, OSBE; A.R. Bos -EULEX, Faton Hamiti- EULEX, Erik Eëig- EULEX, Sanije Berisha, OSBE; Luanda Domi, DCAF, Venera Gashi-praktikante, Adem Breznica-KosovaLive, Alban Brajshoqi - Rrokum Tv, Fidan Rama- Tribuna, Ermal Panduri – Dukagjini.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli, Zarife Aliu dhe Antigona Ibraj.

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit të mbajtur, më 24.05.2013;
3. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin Policor;

4. Diskutim rreth pjesëmarrjes së komisionit në punëtorinë për mbikëqyrjen e sigurisë dhe inteligjencës që mbahet në Ohër me 24-26 Qershor;
5. Të ndryshme;

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me një pikë shtesë.- Informatë në lidhje me suspendimin e policëve të Kosovës me rastin e vizitës së z.Vulin në Kosovë.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 24.05.2013

Procesverbali i mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 24.05.2013, u miratua pa ndryshime.

3. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin Policor

Kryetari i Komisionit- Ne si komision e kemi formuar grupin punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin Policor, i cili ka punuar dhe ka sjell para komisionit një raport për punën e bërë gjatë mbikëqyrjes së këtij Ligji. Andaj pa humbur kohë fjalën ja jap kryesuesit të këtij grupi z.Rexhep Selimi.

Rexhep Selimi- Në vitin e kaluar komisioni ka marr vendim për themelimin e grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin Policor. Ky grup punues ka qenë mjaft aktiv. Ky grup ka pasur vizita në institucionet e ndryshme siç janë: Inspektorati Policor, Ombduspersoni dhe Prokuroria e Shtetit. Në fund tërë ky aktivitet është përmbyllur me një dëgjim publik me Kuvend.

Gjatë aktiviteteve të këtij grupi punues grupi ka gjetur shumë të gjetura dhe në përputhje me të gjeturat janë bërë edhe rekomandimet të cilat u janë paraqitur komisionit për miratim. Ajo që është me rëndësi në këtë mbikëqyrje janë të gjetura dhe besoi që pas miratimit ne seancë këto të gjetura do të ndikojnë në përmirësimin, korrigjimin dhe rritjen e përgjegjësisë në këtë institucion. Andaj propozoi që ky raport të miratohet në komision dhe të procedohet pastaj për miratim në seancë. Unë e falënderoj grupin punues dhe administratën mbështetëse të cilët kanë bërë punë të madhe që ne ta kemi një raport të këtillë pas një punë shumë të madhe, kështu që pres që komisioni ta mbështes këtë raport.

Fatmir Xhelili- Grupi punues ka bërë një punë të mirë dhe ka pasur një qasje serioze. Është e vërtet që ka të meta dhe lëshime në zbatim të Ligjit për Inspektoratin Policor, mirëpo janë të meta të cilat që kanë hapësirë për korrigjim qysh e ka qëllimin edhe vet puna e këtij grupi punues për ti evidentuar ato lëshime në mënyrë që të këtë përmirësime nga ana e Inspektoratit Policor. Unë shpresoj se me këto rekomandime që kanë dal nga ky raport dhe me rritjen e përkushtimit të punës së menaxherëve të Inspektoratit Policor do të kenë kapacitet që për një kohë të shkurt të merren me punën e vet dhe me objektivat për të cilat detyrohen me Ligjin për Inspektoratin Policor dhe se do të jenë të suksesshëm.

Kryetari- Konstatoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me votim unanim e miratoi Raportin për mbikëqyrjen e Ligjit për Inspektoratin Policor. Raporti me rekomandime për mbikëqyrjen e Ligjit për Inspektoratin Policor të procedohet për seancë. Z.Rexhep Selimi raporton në seancën e Kuvendit.

4. Diskutim rreth pjesëmarrjes së komisionit në punëtorinë për mbikëqyrjen e sigurisë dhe inteligjencës që mbahet në Ohër me 24-26 Qershor

Kryetari i Komisionit- Ju e dini që në bashkëpunim me DCAF, jemi dakorduar që do ta kemi një punëtori, në të cilën do të marrin pjesë të dy komisionet Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK dhe Komisioni për AKI. Ju lutem ta konfirmoni te administrata se kush do të marr pjesë në këtë punëtori në mënyrë që rezervimi dhe të gjitha përgatitjet të bëhen me kohë.

5.Të ndryshme

Kryetari – Unë e kamë këtu një informatë të cilën e kemi kërkuar nga MPB në lidhje me suspendimin e policëve të Kosovës me rastin e vizitës së z.Vulin në Kosovë. Ne këtë informatë e kemi vetëm në gjuhën shqipe edhe pse ne vazhdimisht kemi kërkuar që çdo informatë ta kemi në të dy gjuhët, andaj kërkoj falje dhe shpresoj që kjo të mos përsëritet më. Fjalën e ka z.Xhelili.

Fatmir Xhelili- Unë kisha propozuar që këtë çështje ta shtyjme për mbledhjen e radhës, meqenëse kjo informatë na u shpërnda tani dhe nëse del diçka që ka nevojë për trajtim në komision ta trajtojmë siç duhet. Po ashtu u kishim dhënë mundësi që të përkthehet nga administrata për pjesëtarët e pakicave në komision.

Kryetari – Atëherë meqë edhe nuk e kemi përkthimin në gjuhën serbe dhe keni nevojë për shqyrtim më të hollësishëm, po e shtyjme këtë çështje për mbledhjen e radhës.

A ka dikush diçka tjetër në të ndryshme.

Pasi që nuk ka diçka në të ndryshme, atëherë unë kërkoj nga media dhe organizatat tjera që ta lirojnë sallën për shkak se kemi një informatë të ndjeshme dhe komisioni e mban mbledhjen me dyer të mbyllura. Ju lutem në sallë mbesin vetëm deputetët.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi

